



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS:

HISTORI ARTI

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësim, 40 seminare.

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti II/,/semestri I

Lloji i lëndës: *e detyrueshme*

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikësi UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Objektivi i lëndës së Historisë së artit në Universitet është që t'u japë studentëve zgjidhjet, zbulojë kuptimin, bukurinë, larminë e gjithçkaje që është universale apo që i përket historisë së njerëzimit;

Objektivat specifike lëndore:

- të njihen me periudhat, rrymat dhe ndikimet historike artistike të qytetërimit evropian perëndimor
- t'u ofrojë mundësinë e njohjes dhe takimit me veprat artistike të epokave dhe qytetërimeve të ndryshme;
- t'i nxisë për të përvetësuar një kulturë vetjake me vlera universale të bazuara në autorët dhe veprat e përzgjedhura për studim;
- t'u mundësojë të rradhiten mes amatorëve të kultivuar, duke përvetësuar në mënyrë të spikatur një fjalor teknik që ofron orientime të domosdoshme në kohë dhe hapësirë, dhe duke vlerësuar kënaqësinë që fal takimi me artin;
- si dhe t'u mësojë elementet informuese mbi profesionet artistike dhe kulturore, lidhur me interesat e tyre në fushën e komunikimit.

Rezultate të pritshme:

Studenti në fund të modulit duhet :

- të njohë dhe dallojë periudhat, rrymat, stilet, fushat artistike dhe autorët evropianë perndimorë të marrë në studim
- të aftësohet në identifikimin e ndikimit artistik mes periudhave dhe rrymave a autorëve
- të përshkruajë, dekodojë kuptimin dhe analizojë modestisht vepra arti